VENDIM
Nr. 436, datë 3.6.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË

(Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 27.1.2021, nr. 363, datë 26.5.2022; nr. 520, datë 30.6.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kandidatët, për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, duhet të kenë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë). Për pranimin në programet e studimit të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, nota mesatare të jetë minimalisht:

a) 7 (shtatë) për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë në fushën e mësuesisë për gjuhët e huaja;

b) 7.5 (shtatë pikë pesë) për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë;

c) 7.5 (shtatë pikë pesë) për pranimin në programin e studimit të ciklit të parë, që përgatit mësues për arsimin parashkollor, program, i cili nuk jep akses në programet e ciklit të dytë në fushën e mësuesisë për arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

2. Shfuqizuar.

3. Përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe *Bujanovci.*

3/1 Kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë), mund të aplikojnë edhe në programet e studimit të gjuhëve të huaja dhe në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë "Master" në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të vendimit, por këta kandidatë pajisen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore me numër të veçantë matrikullimi, i cili nuk i lejon të ndjekin më pas programet e ciklit të dytë "Master" në fushën e mësuesisë.

4. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik, që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016–2017 dhe në vijim.

5. Nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë vijon:

a) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;

b) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

6. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

7. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, si dhe përllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë të kryhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, sipas përcaktimeve të pikës 5 të këtij vendimi. Në rastet kur nuk aplikohen provimet e Maturës Shtetërore, komisioni përkatës përcakton mënyrën e përllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës dërgon të dhënat tek institucioni arsimor vendor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1

(Ndryshuar me vendimin nr. 520, datë 30.6.2026)

Nr.	**Institucionet e arsimit të lartë**	**Programet e studimit *"Bachelor"* për gjuhët e huaja**	**Nota mesatare 7**	**Programet e studimit *"Bachelor"*, që japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë**	**Nota mesatare 7.5**	**Programet e studimit *"Bachelor"* për arsimin parashkollor, që nuk japin akses në programet e ciklit të dytë master për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë**	**Nota mesatare 7.5**
1	Universiteti i Tiranës	Gjuhë angleze	7	Gjuhë-letërsi	7.5		-
		Gjuhë frënge		Biologji			
		Gjuhë, letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës		Kimi			
		Italianistikë, profili gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian		Matematikë			
		Gjuhë turke		Fizikë			
		Gjuhë greke		Informatikë			
		Gjuhë spanjolle me profil gjuhë-letërsi dhe qytetërim hispanik		Gjeografi			
		Gjuhë frënge dhe gjuhë e shenjave shqip		Histori			
				Filozofi			
				Psikologji			
				Sociologji			
2	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	Gjuhë angleze	7	Gjuhë-letërsi	7.5	Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
		Gjuhë gjermane dhe angleze		Matematikë-informatikë			
				Mësuesi për arsim fillor			
				Psikologji			
				Filozofi-sociologji			
		Gjuhë angleze		Biologji-kimi			
				Histori-gjeografi			

3	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	Gjuhë frënge Gjuhë gjermane Gjuhë italiane	7	Gjuhë shqipe dhe letërsi Matematikë informatike Matematikë-fizikë Mësuesi për arsim fillor Psikologji Filozofi-sociologji	7.5	Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
4	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	Gjuhë angleze Gjuhë frënge Gjuhë gjermane Gjuhë italiane	7	Biologji-kimi Fizikë Gjeografi Gjuhë-letërsi Histori Informatikë Matematikë Mësuesi për arsim fillor Psikologji Pedagogji muzikore	7.5	Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
5	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	Gjuhë angleze Gjuhë italiane	7	Biologji Kimi Matematikë Matematikë-fizikë Matematikë-informatikë Informatikë Gjuhë shqipe dhe letërsi Histori-gjeografi Mësuesi për arsimin fillor Pedagogji e specializuar	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
6	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	Gjuhë angleze Gjuhë dhe kulturë frënge	7	Matematikë-fizikë Biologji-kimi Histori-gjeografi Gjuhë-letërsi Mësuesi për arsim fillor	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
7	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër	Gjuhë angleze	7	Biologji-kimi Gjuhë-letërsi shqipe Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek Histori-gjeografi Matematikë-informatikë	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5

				Mësuesi për arsimin fillor			
8	Universiteti "*Albanian University*"	Gjuhë angleze	7	Mësuesi për arsimin fillor Psikologji e përgjithshme	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
9	Kolegji Universitar *"Logos"*	Gjuhë dhe civilizim grek	7			Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
10	Kolegji Universitar "Bedër"	Gjuhë dhe letërsi angleze	7				
11	Universiteti "Barleti"			Psikologji	7.5		
12	Universiteti Evropian i Tiranës			Psikologji	7.5		7.5
13	Universiteti *"New York* i Tiranës"			Psikologji Gjuhë dhe letërsi turke	7.5		7.5
14	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë			Mësuesi për arsimin fillor Psikologji e përgjithshme	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5